

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga burgu te kurora mbretërore, portieri 1.98 metra, që u zgjodh mbret në Ugandë
ADRESA	https://tpz.al/nga-burgu-te-kurora-mbreterore-portieri-1-98-metra-qe-u-zgjodh-mbret-ne-u-gande-i332985
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:56:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:55:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bfad4a7a4d4aabe46043a52585546755b7222d1eca9f6d4ec1cec57a6675ce49
TEKSTI	382ff16d82a74478dce8c001db2a1f0b79bcc4adcc40265a37366a2b9039235d
PAMJA	2315e479ff2b1dd57489eb48efccca40c6a43a8a52295f7ebd49220368c0d9a8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0a25562a0718b7b07715f3e033a7e3d6dcfc3c474b8b94e32f79ce92e3a8145e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0a25562a0718b7b07715f3e033a7e3d6dcfc3c474b8b94e32f79ce92e3a8145e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

14:00 Përplasja vazhdon/ Gjykata Administrative urdhëron Ministrinë e Financave të zhblokojë pagat e magistratëve në Lezhë • 13:50 Vendimet e KLGJ/ Paulin Çera ngrih

LIFESTYLE, 15 SEPTEMBER 2026, 1555

Nga burgu te kurora mbretërore, portieri 1.98 metra, që u zgjodh mbret në Ugandë

tpz.al TPZ



Historia e jashtëzakonshme vjen nga Londra dhe duket më shumë si skenar filmi sesa si një ngjarje reale. George Desmond Kamurasi, portier i një skuadre të ligave të ulëta angleze dhe njëkohësisht yll i rrjeteve sociale, është zgjedhur si sundimtari i ri i Mbretërisë së Toros në Ugandë.

Nga rrugët e Londrës dhe një periudhë në burg në adoleshencë, te futbollit i ligave të ulëta angleze dhe tani drejt fronit mbretëror në Afrikë. Kjo është historia e jashtëzakonshme e 36-vjeçarit George Desmond Kamurasi.

Nga Londra në portat e futbollit

Kamurasi është 1.98 metra i gjatë dhe prej vitesh luan si portier në nivelet e ulëta të futbollit anglez. Ai ka veshur fanellat e klubeve si Ashford United, Hightown dhe Greenwich, ndërsa është bërë veçanërisht i njohur si kapiten dhe portier i parë i SE Dons. Klubi londinez luan në nivelin e nëntë të piramidës së futbollit anglez dhe ka fituar një popullaritet të madh në YouTube dhe rrjetet sociale. SE Dons u themelua nga reperi britanik Don Strapzy. Kamurasi, i njohur me nofkën "Big G", u kthye në një personazh të njohur në internet falë videove nga dhoma e zhveshjes. Si kapiten, ai është bërë i famshëm për fjalimet e tij të zjarrta, me zë të lartë dhe jashtëzakonisht motivuese para ndeshjeve.

Një e kaluar e vështirë

Pas kësaj figure të zhurmshme dhe karizmatike fshihet një fëmijëri aspak e lehtë. Kamurasi humbi nënën e tij kur ishte vetëm 14 vjeç. Pas kësaj, ai u shoqërua me njerëz të gabuar dhe, ende në moshë adoleshente, përfundoi në burg. Ishte pikërisht në qelinë e burgut, sipas rrëfimeve të tij, kur kuptoi se duhej të ndryshonte jetën dhe të merrte përgjegjësi për të ardhmen e tij. Pas lirim, iu përkushtua sportit dhe punës me të rinjtë. Madje arriti të bëhej pjesë e Akademisë Nike dhe, gjatë një kampi në Barcelonë, u stërvit e luajti nën drejtimin e Pep Guardiols.

Nga fanella te kurora

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati


Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tiera video

Por historia e Kamurasit nuk do të kishte asgjë të zakonshme edhe sikur të kishte përfunduar këtu. Portieri londinez është pasardhës i dinastisë mbretërore Babito në Ugandë. Gjyshi i tij ishte George Rukidi III, ish-mbret i Mbretërisë së Toros, i cili në vitin 1954 priti edhe Mbretëreshën Elizabeth II gjatë vizitës së saj në Ugandë. Pas vdekjes së ish-mbretit të Toros, Oyo Nyimba Kabamba Iguru Rukidi IV, në shtator 2026, u mbledh Komiteti Mbretëror i Pasardhësit për të përcaktuar sundimtarin e ri. Nga 18 anëtarë të pranishëm, 15 votuan pro Kamurasit. Kështu, portieri 36-vjeçar i një skuadre të ligave të nënta të Anglisë u zgjodh si Omukama, titulli tradicional i mbretit të Toros.

Mbreti që nuk donte të largohej nga Londra

Zgjedhja e tij solli menjëherë një dilemë të jashtëzakonshme. Kamurasi jeton në Londër me bashkëshorten e tij angleze, Abby Rook, dhe djalin e tyre. Për këtë arsye, ai fillimisht ka hezituuar të largohet nga Anglia dhe të marrë përsipër përgjegjësitë mbretërore në Ugandë. Nëse ai vendos të marrë plotësisht detyrat e tij në pallatin Karuzika, në qytetin Fort Portal, jeta e tij do të ndryshojë rrënjësisht.

Djali i tij, ndërkohë, është tashmë pjesë e linjës së drejtpërdrejtë të trashëgimisë së dinastisë Babito dhe, në të ardhmen, mund të jetë ai që do të trashëgojë fronin.

Një mbret 1.98 metra i gjatë

Mbretëria e Toros është një nga monarkitë tradicionale të Ugandës që gëzon status kushtetues dhe ka një rol të rëndësishëm kulturor për popullsinë Batoro. Ndërsa Kamurasi po përballlet me vendimin më të madh të jetës së tij, në Angli ai vazhdon të njihet si "Big G", portieri i gjatë dhe kapiteni energjik i SE Dons. Me shtatlartësinë prej 1.98 metrash, ai është një figurë dominuese në duelet ajrore dhe njihet për komunikimin e fortë me mbrojtjen. Gjithashtu, është i famshëm për aftësinë në pritjen e penalltive, ku shpesh përpiqet të fitojë edhe betejën psikologjike me ekzekutuesin.

Nga një qeli burgu në Londër, te portat e futbollit të ligave të ulëta dhe tani drejt fronit në Afrikë, një histori që vështirë të besohet, por që është kthyer në realitet për George Desmond Kamurasin.

LIFESTYLE / 14 September 2026, 18:53

I mbijetoi ferrit të Auschwitz-it, ndahet nga jeta në moshën 107-vjeçare një nga dëshmitarët e Holokaustit

LIFESTYLE / 13 September 2026, 14:07

Dua Lipa përballlet me Samsung në gjykatë, kompania kërkon rrezimin e padisë 15 milionë dollarëshe

LIFESTYLE / 13 September 2026, 10:54

Rikthehet Celine Dion, ikona e muzikës performon live përballë fansave në Paris pas më shumë se gjashtë vitesh

LIFESTYLE / 12 September 2026, 22:15

Video/ Celine Dion rikthehet në skenë pas më shumë se gjashtë vitesh, emocionon 30 mijë spektatorë

LIFESTYLE / 12 September 2026, 21:27

Nga miqësia te dashuria/ Jennifer Aniston dhe Jim Curtis zbulojnë si nisi romanca e tyre

LIFESTYLE / 12 September 2026, 19:18

Nevina Shtylla, shtatzënë për herë të parë, moderatorja ndan pamjet: Sekreti më i ëmbël që kam mbajtur ndonjëherë

LIFESTYLE / 11 September 2026, 17:19

FOTO/ Rosalía nuk e fsheh më dashurinë, puth partneren në buzë gjatë ndeshjes së US Open në New York

LIFESTYLE / 10 September 2026, 18:34

"Fustani i hakmarrjes" i Princeshë Dianës del në ankand! Veshja ikonike pritet të shitet deri në 300 mijë dollarë

LIFESTYLE / 10 September 2026, 17:37

Shkencëtarët grekë ngrenë alarmin për trajtimet "kundër plakjes": "Shkenca ka nevojë për prova, jo premtime"

LIFESTYLE / 9 September 2026, 17:53

Një nga ikonat e muzikës greke/ Kush ishte Giorgos Mazonakis që prej vitesh pushtoi skenën, këngët që shënjuan karrierën e tij

LIFESTYLE / 9 September 2026, 17:14

Arti grek në zi, ndahet nga jeta
parakohe këngëtari i
mirënjohur Giorgos
Mazonakis

LIFESTYLE / 7 September 2026, 17:18

Beyonce feston 45-vjetorin me
një gjest të rrallë, këngëtarja
dhuron 2 milionë dollarë për
Muzeun e Studios në Harlem

LIFESTYLE / 5 September 2026, 21:22

Kurorëzoi dashurinë 4 ditë më
parë, Kida publikon fotot e
dasmës në Romë

LIFESTYLE / 5 September 2026, 20:41

"Nuk është aventurë verore" -
20 vite diferencë në moshë, i
riu rrëfen lidhjen me vajzën e
Brigitte Macron: Jemi të
dashuruar

LIFESTYLE / 2 September 2026, 09:33

Feston 60-vjetorin e lindjes,
Parashqevi Simaku ka dy
dëshira! Të takohet me djalin
dhe rikthimi në Shqipëri

LIFESTYLE / 30 August 2026, 17:52

Rita Ora rikthehet te
thashethemet për Beyoncé
dhe Jay-Z: Do të doja ta dija
kush e nisi historinë e 'Becky'

LIFESTYLE / 29 August 2026, 09:44

"Duhej të ishte mbretëresha e
botës", fansat kujtojnë Dolly
Parton për mirësinë, bujarinë
dhe ndikimin që pati në jetët e
tyre

LIFESTYLE / 28 August 2026, 14:33

Dua Lipa nuk i ndal pushimet,
"arratiset" në Formentera me
motrën dhe vëllain

LIFESTYLE / 27 August 2026, 15:11

Ndërron jetë artistja e famshme japoneze e "pikave", Yayoi Kusama

LIFESTYLE / 26 August 2026, 22:55

Eros Ramazzotti i nënshtrohet operacionit në kordat vokale, shtyn turneun në Amerikë deri në 2027

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.